

## Член 48

Глоба во износ од 25 до 50 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на овластеното службено лице од органот кој ја води постапката и надлежниот јавен орган од кој се побарани доказите и податоците, ако:

- не ги прибави доказите во рок од три дена од денот на приемот на барањето (член 5 став (2)),
- не ги достави бараните докази и податоци во рок од три дена од денот на приемот на барањето (член 5 став 3) и
- не одлучи по барањето во рок од 30 дена од денот на приемот на барањето (член 13).

## Член 49

За прекршоците утврдени во членовите 42, 43, 44, 45, 46 и 47 од овој закон прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува прекршочниот орган – Прекршочна комисија, во рамките на министерството надлежно за работите од областа на трудот.

## Порамнување

## Член 50

Доколку при вршење на инспекциски надзор над примената на овој закон се утврди повреда која е утврдена како прекршок со овој закон, од страна на овластеното службено лице на сторителот на прекршокот задолжително ќе му се понуди постапка за порамнување, согласно со Законот за прекршоците.

## Одмерување на казна

## Член 51

Одмерувањето на висината на глобата за правното лице се врши согласно со Законот за прекршоците.

## Член 52

Државниот инспекторат за труд, за извршените контроли изготвува квартални извештаи, кои се објавуваат на веб страницата на министерството надлежно за работите од областа на трудот и на веб страницата на Државниот инспекторат за труд.

## VI. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

## Член 53

Со денот на влегувањето во сила на овој закон престанува да важи Законот за агенциите за привремени вработувања („Службен весник на Република Македонија” број 49/2006, 102/2008, 145/10, 136/11, 13/13, 38/14, 98/15, 147/15, 27/16, 119/16 и 21/18).

## Член 54

Подзаконските акти предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од 60 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

## Член 55

(1) Постојните агенции за привремени вработувања и агенциите за посредување за вработување, се должни да поднесат барање согласно со овој закон за издавање на лиценца од членот 7 став (1) од овој закон, во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

(2) На постојните агенции за привремени вработувања и агенциите за посредување за вработување коишто нема да поднесат барање во рокот од ставот (1) на овој член, ќе им престанат со важност лиценците издадени пред денот на влегувањето во сила на овој закон.

## Член 56

Започнатите постапки до денот на влегувањето во сила на овој закон, ќе завршат согласно со Законот за агенциите за привремени вработувања („Службен весник на Република Македонија” број 49/2006, 102/2008, 145/10, 136/11, 13/13, 38/14, 98/15, 147/15 и 27/16) и Законот за вработувањето и осигурување во случај на невработеност („Службен весник на Република Македонија” број 37/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003, 37/2004, 4/2005, 50/2006, 29/2007, 102/2008, 161/2008, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12, 114/12, 39/14, 44/14, 113/14, 56/15, 129/15, 147/15, 154/15, 27/16, 119/16 и 21/18).

## Член 57

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија”.

## L I G J

## PËR AGJENCI PRIVATE PËR PUNËSIM

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

## Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe procedura për themelim dhe punë të agjencive private për punësim.

## Neni 2

(1) Agjencia private për punësim themelohet për kryerjen e një ose më tepër punëve si në vijim:

- punësim i përkohshëm,
- ndërmjetësim për punësim në vend,
- ndërmjetësim për punësim jashtë vendit dhe
- ndërmjetësim për punësim në vend dhe jashtë vendit.

(2) Agjencia private për punësim nuk mund të kryej veprimtari tjetër përveç veprimtarisë për të cilën është regjistruar.

(3) Agjencia private për punësim mund të arkëtojë kompensim për shërbimet e kryera kryesisht nga punëdhënësi shfrytëzues ose punëdhënës potencial.

## Definicione

## Neni 3

(1) Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë domethënien në vijim:

1. "Agjencia private për punësim" është person juridik që në përputhje me ligj, kryen punësime të përkohshme dhe / ose ndërmjetësim për punësim me arkëtim;

2. "Punëdhënësi shfrytëzues" është person juridik ose fizik për të cilin dhe nën mbikëqyrjen dhe menaxhimin e të cilit punon punëtori i përkohshëm i agjencisë;

3. "Punëtori i përkohshëm i agjencisë" është punëtori i cili në bazë të marrëveshjes së lidhur për punësim me agjencinë private për punësim me licencë për punësime të përkohshme, i kaluar për punë të përkohshme te punëdhënësi shfrytëzues që të punojë nën mbikëqyrjen dhe menaxhimin e tij;

4. "Periudha e kalimit" nënkupton periudhën në të cilën punëtori i agjencisë së përkohshme ka kaluar për punë të përkohshme tek punëdhënësi shfrytëzues;

5. "Punëdhënësi potencial" është person juridik ose fizik në vend ose jashtë vendit, te i cili dërgohet personi për punësim të mundshëm;

6. "Kërkuesi i punës" është person fizik i cili është shfrytëzues i shërbimeve të agjencisë private për punësim, për punësimin e tij të mundshëm;

7. "Personi i dërguar për punësim të mundshëm" është person fizik i cili dërgohet te punëdhënësi potencial për punësimin e tij të mundshëm, në bazë të marrëveshjes së lidhur me agjencinë private për punësim e cila kryen ndërmjetësim për punësim;

8. "Kushtet themelore për punë dhe punësim" paraqesin kushte për punë dhe punësim të përcaktuara me ligj, marrëveshje kolektive dhe akte të punëdhënësit shfrytëzues, të cilët i referohen kohëzgjatjes së orarit të punës, punës jashtë orarit, pauzave, periudhave të pushimit, punës së natës, festave dhe kompensimeve;

9. "Ndërmjetësimi për punësim" është veprimtari e agjencisë private për punësim me licencë për ndërmjetësim për punësim në vend dhe / ose jashtë vendit, për përmbushjen e kërkesave të punëdhënësit potencial dhe kërkuesit të punës për punësim.

10. "Punësimi afatshkurtër" është punësimi në bazë të marrëveshjes për punësim të përkohshëm të punëtorit të agjencisë nga ana e agjencisë private për punësim, me kohëzgjatje më së shumti deri 90 orë pune gjatë muajit.

(2) Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në raste të ndërmjetësimit për punësimin e studentëve jashtë vendit gjatë periudhës së studimeve.

#### Neni 4

(1) Agjencitë private për punësim kanë trajtim të barabartë me Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë në ndërmjetësimin për punësim dhe qasjen në bazën e të dhënave për personat e papunësuar në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë, për zgjedhjen e kandidatëve për punësim.

(2) Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë dhe agjencitë private për punësim shkëmbejnë informacione ndërmjet veti për vendet e lira të punës dhe dërgimin e personave të papunësuar për punësim.

(3) Shkëmbimi i informatave nga paragrafi (2) i këtij neni kryhet në formë elektronike, në bazë të marrëveshjes së lidhur paraprakisht.

## II. PROCEDURA PËR THEMELIMIN E AGJENCISË PRIVATE PËR PUNËSIM

#### Neni 5

(1) Agjenci private për punësim mund të themelojë personi fizik ose juridik në kushte dhe në procedurën e parashikuar në këtë ligj.

(2) Personi fizik mund të themelojë agjenci private për punësim nëse i plotëson kushtet në vijim:

- ka së paku arsimin e mesëm dhe
- nuk i është shqiptuar masë ndalim për kryerjen e veprimtarisë.

(3) Personi juridik mund të themelojë agjenci private për punësim, nëse është i regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe nëse i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

#### Neni 6

(1) Procedura për themelimin e agjencisë private për punësim ngrihet me paraqitjen e kërkesës në ministrinë kompetente për punët nga sfera e punës.

(2) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për themelimin e agjencisë private për punësim i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(3) Përmbushjen e kushteve nga neni 5 i këtij ligji, e përcakton Komisioni, i formuar nga ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(4) Me propozimin e Komisionit nga paragrafi (3) i këtij neni, ministri kompetent për punët nga sfera e punës miraton aktvendim për themelimin e agjencisë private për punësim, në bazë të së cilës bëhet regjistrimi në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

(5) Me regjistrimin në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, agjencia private për punësim do të marrë cilësinë e personit juridik.

(6) Pas regjistrimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, agjencia private për punësim ministrisë kompetente për punët nga sfera e punës ia dorëzon të gjitha dokumentet e nevojshme dhe dëshmitë e nevojshme për përmbushjen e kushteve të nevojshme për marrjen e secilës licencë adekuate nga nenet 9 dhe 11 të këtij ligji.

(7) Agjencia private për punësim nuk mund të fillojë punën para regjistrimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë dhe marrjes së licencës përkatëse të lëshuar nga ministria kompetente për punët nga sfera e punës.

(8) Nëse nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, ministria kompetente për punët nga sfera e punës do të miratojë aktvendim për refuzimin e kërkesës.

(9) Kundër aktvendimeve nga paragrafët (4) dhe (8) të këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit, në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

## LICENCA

### Neni 7

(1) Ministria kompetente për punët nga sfera e punës lëshon licenca për:

- punësime të përkohshme,
  - ndërmjetësim për punësim në vend,
  - ndërmjetësim për punësim jashtë vendit dhe
  - ndërmjetësim për punësim në vend dhe jashtë vendit.
- (2) Për punësime të përkohshme lëshohen licencat në vijim:

- LICENCA A - për lidhjen e marrëveshjeve për punësime të përkohshme për mbi 500 punëtorë të përkohshëm të agjencisë,

- LICENCA B - për lidhjen e marrëveshjeve për punësime të përkohshme nga 251 deri 500 punëtorë të përkohshëm të agjencisë,

- LICENCA V - për lidhjen e marrëveshjeve për punësime të përkohshme nga 101 deri 250 punëtorë të përkohshëm të agjencisë dhe

- LICENCA G - për lidhjen e marrëveshjeve për punësime të përkohshme deri 100 punëtorë të përkohshëm të agjencisë.

(3) Numri i marrëveshjeve të lidhura për punësim të përkohshëm të cilat janë përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, kanë të bëjnë me numrin e marrëveshjeve aktive për punësime të përkohshme dhe i njëjti nuk duhet ta tejkalojë numrin e marrëveshjeve për të cilat është dhënë licenca përkatëse për kryerjen e punësimeve të përkohshme, në çdo moment në muajin rrjedhës.

(4) Agjencia private për punësim mund njëkohësisht të ketë licencë për punësime të përkohshme dhe licencë për ndërmjetësim të punësimit, nëse i plotëson kushtet për marrjen e secilës licence në veçanti.

### Neni 8

(1) Ministria kompetente për punët nga sfera e punës mban regjistër të agjencive private për punësim.

(2) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(3) Inspektorati Shtetëror për Punë kryen mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji.

(4) Ministria kompetente për punët nga sfera e punës kryen mbikëqyrje mbi punën e agjencive private për punësim.

(5) Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë i siguron qasje personit të autorizuar nga ministria kompetente për punët nga sfera e punës në sistemin elektronik, me qëllim të verifikimit të numrit të punëtorëve tek agjencitë private për punësim.

## KUSHTE PËR MARRJEN E LICENCËS

### Licenca për punësime të përkohshme

#### Neni 9

(1) Për marrjen e licencës - A për punësime të përkohshme, agjencia private për punësim duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- të ketë garanci bankare në lartësi prej 50.000 euro në kundërvlerë në denarë, e llogaritur sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë,

- të ketë hapësirë afariste në të njëjtin lokacion në pronësi apo me qira, prej së paku 60 m<sup>2</sup>, që i plotëson kërkesat në përputhje me rregullat për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe

- të ketë së paku gjashtë persona të punësuar me kohë të pacaktuar me orar të plotë pune.

(2) Për marrje të licencës - B për punësime të përkohshme, agjencia private për punësim duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- të ketë garanci bankare në lartësi prej 30.000 euro në kundërvlerë me denarë, e llogaritur sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë,

- të disponojë me hapësirë afariste në të njëjtin lokacion, në pronësi apo me qira, prej së paku 50 m<sup>2</sup>, që i plotëson kushtet në përputhje me rregullat për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe

- të ketë së paku pesë persona me kohë të pacaktuar, me orar të plotë pune.

(3) Për marrje të licencës - V për punësime të përkohshme, agjencia private për punësim duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- të ketë garanci bankare në lartësi prej 20.000 euro në kundërvlerë me denarë, e llogaritur sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë,

- të disponojë me hapësirë afariste në të njëjtin lokacion, në pronësi apo me qira, prej së paku 40 m<sup>2</sup>, që i plotëson kushtet në përputhje me rregullat për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe

- të ketë së paku katër persona të punësuar me kohë të pacaktuar, me orar të plotë pune.

(4) Për marrje të licencës - G për punësime të përkohshme, agjencia private për punësim duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- të ketë garanci bankare në lartësi prej 10.000 euro në kundërvlerë me denarë, e llogaritur sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë,

- të disponojë me hapësirë afariste në të njëjtin lokacion, në pronësi apo me qira, prej së paku 20 m<sup>2</sup>, që i plotëson kushtet në përputhje me rregullat për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe

- të ketë së paku dy persona të punësuar me kohë të pacaktuar, me orar të plotë pune.

(5) Garancinë bankare nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, banka e dorëzon tek ministria kompetente për punët nga sfera e punës.

(6) Garancia bankare nuk mund të tërhiqet për periudhën e vlefshmërisë së licencës edhe tre muaj shtesë pas skadimit të vlefshmërisë së licencës pa pëlqimin e ministrisë kompetente për punët nga sfera e punës.

(7) Agjencia private për punësim është e detyruar ta njoftojë ministrinë kompetente për punët nga sfera e punës për hapjen e filialit në afat prej 5 ditëve nga dita e regjistrimit të filialit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 10

(1) Garancia bankare do të arkëtohet nëse agjencia private për punësim me licencë për punësime të përkohshme të punësuarit nuk ia ka paguar pagën dhe kompensime të pagës tre muaj nga dita e krijimit të detyrimit.

(2) Garancia bankare, në shumë të plotë ose të pjesërishtme, arkëtohet pas dorëzimit të njoftimit nga ministria kompetente për punët nga sfera e punës pas procesverbalit të pranuar paraprakisht nga Inspektorati Shtetëror i Punës për rroga të papaguara dhe kompensimin e rrogave nga ana e agjencisë private për punësim me licencë për punësime të përkohshme dhe dëshmi për detyrimet e pashlyera në bazë të rrogave dhe kompensimeve të rrogave nga Drejtoria e të Ardhurave Publike.

(3) Pas mbikëqyrjes së kryer nga Inspektorati Shtetëror i Punës në të cilin do të përcaktohet periudha për pagesën e rrogave dhe kompensimeve të rrogave dhe numri i të punësuarve të cilëve rrogat dhe kompensimet e rrogave nuk u janë paguar, do të bëhet arkëtimi i mjeteve nga garancia bankare, në përputhje me ligjin, në vëllimin e mjeteve nga garancia.

#### Licenca për ndërmjetësim për punësim

##### Neni 11

(1) Për marrjen e licencës për ndërmjetësim për punësim në vend, agjencia private për punësim duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- të disponojë me hapësirë afariste në të njëjtin lokacion, në pronësi apo me qira, prej së paku 30 m<sup>2</sup>, që i plotëson kushtet në përputhje me rregullat për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe

- të ketë të paktën dy persona të punësuar me kohë të pacaktuar, me orar të plotë pune.

(2) Për marrjen e licencës për ndërmjetësim për punësim në vend, agjencia private për punësim duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- të disponojë me hapësirë afariste në të njëjtin lokacion, në pronësi apo me qira, prej së paku 30 m<sup>2</sup>, që i plotëson kushtet në përputhje me rregullat për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe

- të ketë të paktën dy persona të punësuar me kohë të pacaktuar, me orar të plotë pune.

(3) Për marrjen e licencës për ndërmjetësim për punësim në vend dhe jashtë vendit, agjencia private për punësim duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- të disponojë me hapësirë afariste në të njëjtin lokacion, në pronësi apo me qira, prej së paku 40 m<sup>2</sup>, që i plotëson kushtet në përputhje me rregullat për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe

- të ketë të paktën tre persona të punësuar me kohë të pacaktuar me orar të plotë pune.

#### PROCEDURA PËR DHËNIEN DHE VLEFSHMËRIA E LICENCËS

##### Neni 12

(1) Licencat nga neni 7 i këtij ligji, i lëshon ministria kompetente për punët nga sfera e punës, me kërkesë të parashtruar më parë nga agjencia private e punësimit, me dëshmi për përmbushjen e kushteve të kërkuara nga nenet 9 dhe 11 të këtij ligji për licencën adekuate, pas mbikëqyrjes së zbatuar paraprakisht nga inspektori për punë plotësimin e kushteve nga neni 5 i këtij ligji.

(2) Mbikëqyrjen nga paragrafi (1) i këtij neni, Inspektorati Shtetëror i Punës e kryen në afat prej 15 ditëve nga pranimi i kërkesës për kryerjen e mbikëqyrjes, të dorëzuar nga ministria kompetente për punët nga sfera e punës.

##### Neni 13

Licencat nga neni 7 i këtij ligji, ministria kompetente për punët nga sfera e punës i lëshon në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të dokumenteve dhe provave për plotësimin e kushteve për marrjen e licencës.

##### Neni 14

(1) Licencat nga neni 7 i këtij ligji, lëshohen në vlefshmëri prej dy vitesh, me mundësi për vazhdimin e tyre.

(2) Vazhdimi i vlefshmërisë së licencës bëhet me parashtrimin e kërkesës në ministrinë kompetente për punët nga sfera e punës, më së voni deri më 60 ditë para skadimit të vlefshmërisë së licencës, duke dorëzuar dokumentet e nevojshme për përmbushjen e kushteve për marrjen e licencës adekuate dhe pas mbikëqyrjes së kryer më parë nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe ka vlefshmëri pas skadimit të vlefshmërisë së licencës së mëparshme.

(3) Pas dy vazhdimëve të njëpasnjëshme, licenca jepet me vlefshmëri për pesë vjet, me mundësi vazhdimi për pesë vjet për çdo licencë të radhës të lëshuar, me kërkesë të agjencisë private për punësim.

(4) Licenca lëshohet dhe është në emër të agjencisë private për punësim si person juridik.

(5) Licenca doemos duhet të vendoset në hapësirat e agjencisë private për punësim.

(6) Nëse gjatë kohëzgjatjes së licencës ka ndryshime në të dhënat e përmbajtura në licencë, ministria kompetente për punët nga sfera e punës do të lëshojë licencë të re për periudhën tjetër të vlefshmërisë së licencës dhe licenca e lëshuar më parë do të shfuqizohet.

(7) Licenca mund t'i bartet në tërësi ose pjesërisht personit tjetër.

#### NDËRPRERJA E VLEFSHMËRISË DHE HEQJA E LICENCËS

##### Neni 15

(1) Licencat nga neni 7 i këtij ligji pushojnë të vlejné dhe agjencia private e punësimit fshihet nga regjistri nga neni 8 i këtij ligji, sipas detyrës zyrtare, në rastet në vijim:

- me ditën e kalimit të vlefshmërisë së licencës, nëse nuk është kërkuar vazhdimi i licencës, në pajtim me këtë ligji ose licenca nuk është vazhduar për shkak të mospërbushjes së kushteve të përcaktuara me këtë ligj,

- nëse në afat prej pesë ditëve nga paraqitja e ndryshimeve në lidhje me kushtet për marrjen e licencës, agjencia private për punësim nuk e njofton për atë ministrinë kompetente për çështjet nga sfera e punës,

- nëse në afat prej 15 ditëve nga dita e njoftimit të ndryshimit të ndodhur nga alineja 2 i këtij paragrafi, agjencia private për punësim nuk paraqet dëshmi për përmbushjen e sërishme të kushteve,

- nëse agjencia private e punësimit e kryen veprimtarinë në kundërshtim me veprimtarinë për të cilën është lëshuar licenca,

- nëse agjencia private e punësimit e ndryshon adresën dhe selinë, kurse për atë në afat prej pesë ditëve nuk e njofton ministrinë kompetente për çështjet nga sfera e punës, për shkak të ndryshimeve në regjistrin dhe Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë,

- nëse personit përgjegjës i agjencisë private për punësim i shqiptohet masë ndalimi për kryerjen e veprimtarisë, detyrës ose profesionit,

- nëse agjencia private e punësimit me licencë për punësimëve të përkohshme, punëtorëve me të cilët kanë lidhur marrëveshje për punësim, nuk ua paguan rrogën dhe kompensimin e rrogës, tre muaj nga dita e krijimit të detyrimit ose rrogën dhe kompensimin e rrogën nuk i paguan në pajtim me ligjin, marrëveshje kolektive, marrëveshje për kalimin e punëtorit dhe marrëveshjen për punësim,

- nëse agjencia private e punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim në vend dhe jashtë vendit, për dy muaj të njëpasnjëshëm ose për tre muaj gjatë vitit kalendarik nuk dorëzon deri te Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë të dhënat në pajtim me nenin 38 të këtij ligji,

- me kërkesë nga ana e themeluesit të agjencisë private të punësimit, kurse pas mbikëqyrjes inspektuese të kryer nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe me konstatimin se i ka paguar rrogat dhe kompensimet e rrogës për të punësuarit për muajin e kaluar ose

- nëse agjencia private e punësimit me licencë për ndërmjetësim vepron në kundërshtim me nenin 38 të këtij ligji.

(2) Kundër aktvendimit të ministrisë kompetente për çështjet nga sfera e punës për lëshimin, vazhdimin dhe heqjen e licencës për punësim të përkohshëm, përkatësisht ndërmjetësim, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15

ditësh nga pranimi i aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.

(3) Ankesa nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

##### Neni 16

(1) Me ditën e ndërprerjes së vlefshmërisë së licencës për punësimëve të përkohshme, pushojnë të vlejné marrëveshjet për kalim dhe marrëveshjet për punësim.

(2) Agjencia private për punësim është e detyruar t'i çajmërojë punëtorët përkohësisht të punësuar ditën e parë të punës nga dita e ndërprerjes së licencës, në të kundërtën të njëjtat do të çajmërohen nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, në bazë të procesverbalit nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës.

#### III. PUNËSIME TË PËRKOHSHME

##### Neni 17

Agjencia private për punësim me licencë për punësimëve të përkohshme kryen punësimëve të përkohshme për punë të përkohshme tek punëdhënësi tjetër, me arkëtim, në pajtim me këtë ligj.

##### Neni 18

Punësimet e përkohshme kryhen në bazë të marrëveshjeve të lidhura paraprakisht:

- për kalimin e të punësuarit ndërmjet agjencisë private të punësimit me licencë për punësim të përkohshëm dhe punëdhënësit shfrytëzues dhe

- për punësim të lidhur ndërmjet agjencisë private të punësimit me licencë për punësimëve të përkohshme dhe punëtorit të agjencisë së përkohshme cili kalon te punëdhënësi shfrytëzues.

##### Neni 19

Kushtet themelore për punë dhe punësim të punëtorëve të agjencive të përkohshëm të cilat duhet të përmbushen për kohëzgjatjen e kalimit të tyre tek punëdhënësi shfrytëzues janë të njëjtat kushte që do të siguroheshin nëse punëtorët do ishin punësuar drejtpërdrejt nga i njëjti punëdhënësi për të kryer punën e njëjtë.

##### Neni 20

Të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, të përmbajtura në rregullat e përgjithshme për marrëdhëniet e punës dhe sigurinë dhe shëndetin gjatë punës, zbatohen edhe për punëtorët e agjencisë private për punësimëve të përkohshme me licencë për punësimëve të përkohshme.

##### Neni 21

(1) Punëdhënësi shfrytëzues është i detyruar t'i informojë punëtorët e agjencisë së përkohshme, për kohën derisa kanë kaluar, për të gjitha shpalljet për vende të lira të punës të publikuara tek punëdhënësi shfrytëzues, duke theksuar në shpalljet publike në vend të dukshëm tek punëdhënësi shfrytëzues ose në rrugë elektronike, sms ose në ueb faqen e internetit të punëdhënësit shfrytëzues, për t'u siguruar mundësi të barabarta për punësim në periudhë të caktuar ose të pacaktuar, si dhe punëtorëve të tjerë.

(2) Punëdhënësi shfrytëzues duhet të sigurojë qasje të barabartë tek punëtorët e agjencive të përkohshme për trajnimin që u jepet të punësuarve tek punëdhënësi shfrytëzues me qëllim për mirësimin e njohurive dhe aftësitë e tyre për punësim dhe avancimin në punë.

##### Neni 22

Në marrëveshjet për punësim nuk mund të përcaktohen dispozitat me të cilët ndalohet ose pengohet lidhja e marrëveshjes për punësim ndërmjet një punëdhënësit shfrytëzues dhe punëtorit të përkohshëm i agjencisë për

kohën e kalimit të tij dhe pas kalimit të tij, dhe nëse marrëveshjet përmbajnë dispozita të tilla, të njëjtat janë të pavlefshme dhe të shfuqizuara, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes.

#### Neni 23

Punëtorët e përkohshëm të agjencisë kanë të drejtë të marrin pjesë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në trupat që i përfaqësojnë punëtorët, në pajtim me dispozitat, formohen tek punëdhënësi shfrytëzues, në të njëjtën mënyrë siç ata do ishin të punësuar drejtpërsëdrejti nga punëdhënësi shfrytëzues për të njëjtën periudhë kohore.

#### Neni 24

(1) Agjencia private e punësimit me licencë për punësime të përkohshme, në bazë të marrëveshjes për kalimin e punëtorit tek punëdhënësi shfrytëzues, kalon punëtor për kryerjen e punës të përkohshme në rastet si vijojnë:

- ndërrimi i përkohshëm i punëtorit që mungon,
- përkohësisht vëllim i rritur i punës,
- punë sezonale,
- punë në projekt,
- punë specifike jo të vazhdueshme që nuk janë pjesë e veprimtarisë kryesore të punëdhënësit shfrytëzues ose
- aktivitete të paparashikueshme afatshkurtra që paraqiten në kryerjen e veprimtarisë kryesore të punëdhënësit shfrytëzues, me kryerjen e punësimeve afatshkurtra.

(2) Marrëveshja për kalimin e punëtorit në kryerjen e punëve të njëjta të përkohshme mund të lidhet për aq kohë sa nevoja të zgjasë, por jo më gjatë se dy vjet, me ose pa ndërprerje.

(3) Agjencia private e punësimit nuk guxon të kalojë punëtor për kryerjen e punëve të njëjta tek i njëjti punëdhënësi më gjatë se dy vjet, me ose pa ndërprerje.

#### Neni 25

(1) Agjencia private e punësimit me licencë për punësime të përkohshme kryen arkëtim të kompensimit për shërbimet e punëdhënësit shfrytëzuesit.

(2) Agjencia private e punësimit me licencë për punësime të përkohshme nuk mund të arkëtojë kompensim për shërbimet e punësimit të përkohshëm nga personat të cilët i punëson dhe i kalon tek punëdhënësi shfrytëzues.

### KALIMI I PUNËTORËVE PËR KRYERJEN E PUNËVE TË PËRKOSSHME

#### Marrëveshje për kalimin e punëtorit tek punëdhënësi shfrytëzues

#### Neni 26

(1) Kalimi i punëtorit për kryerjen e punëve të përkohshme kryhet në bazë të marrëveshjes për kalimin e punëtorit të cilën e lidhin agjencia private për punësim me licencë për punësime të përkohshme dhe punëdhënësi shfrytëzues.

(2) Marrëveshja për kalimin e punëtorit detyrimisht lidhet në formë me shkrim.

(3) Ekzemplar nga çdo marrëveshje e lidhur për kalimin e punëtorit ruhet në hapësirat e punës në të cilën është regjistruar selia e agjencisë private për punësim dhe e punëdhënësit shfrytëzues.

(4) Marrëveshja për kalimin e punëtorit nga paragrafi (1) të këtij neni, detyrimisht përmban:

- të dhëna për palët kontraktuese,
- vendi i punës dhe lloji i punëve që do t'i kryejë punëtori i cili kalon,
- vendi në të cilin do të kryhen punët,
- të dhëna për kohën e punës, orari i kohës së punës, orët e punës,

- numri i punëtorëve të cilët janë të nevojshëm për shfrytëzuesin,

- kualifikimet e nevojshme të punëtorëve për kryerjen e punëve,

- të dhëna për lartësinë e rrogës bazë,

- periudha për të cilën kërkohet kalimi i punëtorit,

- person për kontakt nga ana e punëdhënësit shfrytëzues,

- periudha në të cilën punëdhënësi shfrytëzues është i detyruar t'i paguajë mjetet për rrogë dhe kompensimet e rrogës, në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive, me ç'rast rroga e punëtorit të përkohshëm të agjencisë nuk mund të jetë më e vogël se rroga e punëtorit tek punëdhënësi shfrytëzues në punë të njëjta ose punë të ngjashme,

- detyrimi i punëdhënësit shfrytëzues për të paraqitur në agjencinë private të punësimit raport për orët e punës të realizuara të punëtorit,

- lartësia e kompensimit për shërbime të agjencisë private për punësim,

- detyrimi i punëdhënësit shfrytëzues që të sigurojë nivel të njëjtë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë të punëtorit të agjencisë së përkohshme si për punëtorët tjerë dhe

- kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të pushimeve dhe mungesat e punëtorit të përkohshëm të agjencisë, në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

(5) Marrëveshja nga paragrafi (1) të këtij neni, nuk mund të lidhet:

- për ndërrim të punëtorit tek punëdhënësi shfrytëzues gjatë kohës së grevës, përveç nëse nuk është siguruar minimum proces për punë në pajtim me ligjin dhe

- për kalimin e punëtorit në agjenci tjetër private të punësimit me licencë për punësime të përkohshme ose nga një në punëdhënësi shfrytëzues tjetër.

#### Neni 27

(1) Agjencia private e punësimit me licencë për punësime të përkohshme përgatit dhe dorëzon llogaritje të veçantë të rrogës dhe kompensime të rrogës, për të punësuarit tek punëdhënësi shfrytëzues individual dhe për të punësuarit në agjencinë private për punësim individual.

(2) Agjencia private e punësimit me licencë për punësime të përkohshme është e detyruar rrogën dhe kompensimet e rrogës të punëtorit të agjencisë së përkohshme të kaluar t'ia paguajë në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive. Nëse punëdhënësi shfrytëzues kryen pagimin e rrogës dhe kompensimeve të rrogës përpara afatit të përcaktuar me ligj dhe me marrëveshje kolektive, agjencia private e punësimit me licencë për punësime të përkohshme mund të paguajë rrogën dhe kompensimet e rrogës ditën e ardhshme pas ditës së pranimit të pagesës nga punëdhënësi shfrytëzues.

#### Neni 28

Nëse punëdhënësi shfrytëzues nuk paguan një faturë ndaj agjencisë private për punësim me licencë për punësime të përkohshme, në afatin e përcaktuar në marrëveshjen për kalim, agjencia ka të drejtë ta prish njëanshëmrisht marrëveshjen e kalimit me punëdhënësin shfrytëzues dhe marrëveshjet për punësim me punëtorët e përkohshëm, pas përmbushjes së detyrimeve nga marrëdhënia e punës me punëtorët e agjencisë së përkohshme dhe për këtë t'i njoftojë punëtorët e agjencisë për punësime të përkohshme dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës.

### Marrëveshja për punësim

#### Neni 29

(1) Agjencia private për punësim me licencë për punësime të përkohshme, para kalimit të punëtorit tek punëdhënësi shfrytëzues, lidh marrëveshje për punësim me punëtorin i cili kalon, në pajtim me dispozitat nga sfera e marrëdhënieve të punës.

(2) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç elementeve të parashikuara në dispozitat nga sfera e marrëdhënieve të punës, detyrimisht duhet të përmbajë edhe:

- të dhëna për palët kontraktuese,
- periudhën për të cilën punëtori kalon tek punëdhënësi shfrytëzues,
- data e fillimit dhe mbarimit të punës tek shfrytëzuesi,
- emërtimi dhe selia e punëdhënësit shfrytëzues,
- vendi i kryerjes së punës,
- përshkrimi i punëve të cilat punëtori i kryen tek punëdhënësi shfrytëzues,
- koha e punës (ditore dhe javore),
- lartësia e rrogës dhe
- obligimet e agjencisë private për punësim tek punëtori në kohën kur ka kaluar te shfrytëzuesi.

#### Neni 30

(1) Rroga bazë e punëtorit të agjencisë së përkohshme nuk mund të jetë më e vogël se rroga e punëtorit tek punëdhënësi shfrytëzues për punë të njëjta, kurse nëse punëtor të tillë nuk ka, nga rroga e punëtorit për punë të ngjashme nga veprimtaria përkatëse.

(2) Punëdhënësi shfrytëzues është i detyruar agjencisë private për punësim me licencë për punësime të përkohshme t'i japë të dhëna të sakta për lartësinë e rrogës bazë të punëtorit të agjencisë së përkohshme.

#### Neni 31

Punëdhënësi shfrytëzues në lidhje me punëtorin e agjencisë së përkohshme konsiderohet si punëdhënës, në kuptim të zbatimit të dispozitave të këtij dhe të ligjeve të tjera, nga sfera e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës dhe është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorit të agjencisë së përkohshme.

#### Neni 32

(1) Punëtori i agjencisë së përkohshme është i detyruar ta kryejë punën sipas udhëzimeve të punëdhënësit shfrytëzues.

(2) Punëtori i agjencisë së përkohshme ka të drejtë ta refuzojë punën në rast kur:

- punëdhënësi shfrytëzues nuk I garanton mbrojtje, në përputhje me dispozitat për sigurinë dhe shëndetin në punë,
- punëdhënësi shfrytëzues e rikalon te punëdhënës shfrytëzues tjetër, në kundërshtim me këtë ligj ose
- punëdhënësi shfrytëzues e vendos atë në pozicion të pabarabartë në bazë të origjinës racore ose etnike, ngjyrën e lëkurës, gjininë, moshën, gjendjen shëndetësore respektivisht invaliditet, bindjen fetare, politike ose bindje tjetër, nënshkrimin në sindikata, origjinën nacionale ose sociale, statusin në familje, gjendjen financiare ose për rrethana të tjera personale, në pajtim me ligjin, marrëveshjen kolektive ose aktin e punëdhënësit.

(3) Punëtori i përkohshëm i agjencisë për punën e refuzuar nga paragrafi (2) i këtij neni është i detyruar ta njoftojë me shkrim punëdhënësin shfrytëzues, agjencinë private të punësimit me licencë për punësime të përkohshme dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës.

#### Neni 33

(1) Marrëveshjen e punësimit, agjencia private e punësimit me licencë për punësime të përkohshme dhe punëtori i agjencisë së përkohshme mund ta ndërpresin para kalimit të kohës për të cilën është lidhur, në rastet e përcaktuara me ligj, me afat skadimi prej së paku shtatë ditësh ose me tjetër afat më të gjatë, të cilin palët do ta dakordojnë, por jo më të gjatë se 30 ditë.

(2) Ndërprerja e nevojës për punëtor tek punëdhënësi shfrytëzues para skadimit të afatit të përcaktuar në marrëveshje nuk mund të jetë shkak për prishjen e marrëveshjes, as ndërmjet punëdhënësit shfrytëzues dhe

agjencisë private për punësim, as ndërmjet agjencisë private për punësim dhe punëtorit përveç në rast tërmeti, zjarri, vërshimeve dhe fatkeqësi të tjera natyrore.

### IV. NDËRMJETËSIMI PËR PUNËSIM

#### Neni 34

(1) Agjencia private e punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim, kryen shërbime ndërmjetësimi për punësim me pagesë, në bazë të marrëveshjes të lidhur me punëdhënës potencial, në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Agjencia private për punësim ndërmjetësimin e kryen me pagimin e kompensimit të shërbimeve për ndërmjetësim nga punëdhënësi.

#### Neni 35

(1) Agjencia private për punësim me licencë për ndërmjetësim për punësim, ndërmjetësimin e kryen në bazë të kërkesës të paraqitur nga punëdhënësi potencial për punësimin e personave të dërguar për punësim të mundshëm për pozicion të caktuar pune.

(2) Agjencia private për punësim me licencë për ndërmjetësim për punësim kryen:

- informim të kërkesit të punës për oferta të hapura për punë,
- biseda paraprake për përcaktim të kualifikimeve të kërkesit të punës,
- kontroll të aftësive dhe kompetencave të kërkesve të punës dhe
- intervistë (bisedë) me punëdhënës potencial.

#### Neni 36

(1) Ndërmjetësimi i punësimit në vend kryhet në bazë të marrëveshjes së lidhur paraprakisht ndërmjet agjencisë private të punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim në vend dhe punëdhënësit të cilin do të dërgohet personi për punësim të mundshëm në vend.

(2) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni detyrimisht përcaktohen kushtet dhe mënyra në lidhje me ndërmjetësimin e punësimit në vend, si dhe kushtet për punësim.

(3) Marrëveshja e ndërmjetësimit për punësim në vend, detyrimisht do t'i përmbajë elementet në vijim:

- emri i plotë i personit juridik respektivisht fizik
- punëdhënës potencial, selia dhe shteti,
- personi përgjegjës tek punëdhënësi potencial,
- kushtet për punësim në pajtim me dispozitat e përgjithshme për marrëdhëniet e punës (orët e punës, vendi i punës, lartësia e rrogës dhe mënyra e pagesës, kushtet e punës dhe ngjashëm) dhe

- të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e agjencisë private për punësim dhe të punëdhënësit tek i cili personi do të dërgohet për punësim të mundshëm në vend.

(4) Punëdhënësi është i detyruar ta njoftojë agjencinë private të punësimit me licencë për ndërmjetësim të punësimit në vend për rezultatin e intervistës për punësim me personin e dërguar për punësim të mundshëm.

(5) Punëdhënësi kryen zgjedhje se me cilët persona të dërguar do të lidhin kontratë për punësim.

(6) Nëse punëdhënësi nuk kryen përzgjedhje të personave të dërguar për punësim të mundshëm, mund të kërkojë nga agjencia private e punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim në vend, të dërgojë persona të tjerë.

(7) Personi i cili dërgohet për punësim të mundshëm në vend, ka të drejtë për kompensim nga punëdhënësi për detyrimet e paplotësuara të marrëveshjes së punësimit, përkatësisht kompensim nga agjencia private e punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim në vend për detyrimet e paplotësuara të marrëveshjes për ndërmjetësim.

## Neni 37

(1) Ndërmjetësimi për punësim jashtë vendit kryhet në bazë të marrëveshjes së lidhur paraprakisht ndërmjet agjencisë private të punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim jashtë vendit dhe punëdhënësit potencial nga jashtë, me të cilin do të organizohet intervistë për punësimin e mundshëm të kërkuësit të punës, i cili aplikon për punësim nëpërmjet agjencisë private të punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim jashtë vendit.

(2) Me marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni detyrimisht përcaktohen kushtet dhe mënyra në lidhje me ndërmjetësimin për punësim jashtë vendit.

(3) Marrëveshja për ndërmjetësim për punësim jashtë vendit detyrimisht do t'i përmbajë elementet si vijojnë:

- emri i plotë i personit juridik respektivisht fizik-punëdhënësi potencial, selia dhe shteti,

- personi përgjegjës tek punëdhënësi potencial,

- kushtet e punësimit të rregulluara nga legjislacioni i shtetit ku do të dërgohet kërkuësi i punës (orët e punës, vendi i punës, shuma e rrogës dhe mënyra e pagesës, kushtet e punës, si dhe kushtet për akomodim dhe kushte të tjera në pajtim me legjislacionin e vendit ku ata janë i referohet kërkuësit të punës),

- kushtet për riatdhësim ( në rast të prishjes së marrëveshjes për punësim) dhe

- kushtet e tjera të përgjithshme që lidhen me ndërmjetësimin gjatë punësimit dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e agjencisë private të punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim jashtë vendit dhe punëdhënësit tek i cili personi do të dërgohet për punësim të mundshëm jashtë vendit.

(4) Agjencia private e punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim jashtë vendit para dërgimit të personit për punësim të mundshëm jashtë shtetit, me personin kërkuës të punës lidh marrëveshje për ndërmjetësim në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet reciproke lidhur me ndërmjetësimin për punësim.

(5) Marrëveshja nga paragrafi (4) i këtij neni duhet t'i përmbajë të gjithë informacionet përkatëse lidhur me: ofertën e punës të paraqitur nga punëdhënësi, pozita e punës, shuma e rrogës dhe mënyra e pagesës, kushtet për punë dhe mënyra e dëmshpërblimit të të dyja palëve për mosrespektimin e marrëveshjes për ndërmjetësim.

(6) Agjencia private për punësim me licencë për ndërmjetësim për punësim jashtë vendit ka obligim të sigurojë marrëveshje për punësim nga ana e punëdhënësit potencial dhe të njëjtën ta dorëzojë për këqyrje te kërkuësi i punës dhe t'i ofrojë atij personalisht ta nënshkruajë atë.

(7) Me përjashtim me paragrafi (6) i këtij neni, për punë në anije, agjencia për punësim që kryen ndërmjetësim për punësim jashtë shtetit ka obligim ta njoftojë kërkuësin e punës me përmbajtjen e marrëveshjes para shkuarjes kurse kërkuësi i punës marrëveshjen për punësim e nënshkruan me vetë ardhjen në anije.

(8) Personi i cili dërgohet për punësim të mundshëm jashtë vendit, ka të drejtë për kompensim nga ana e punëdhënësit për detyrimet e paplotësuara të marrëveshjes së punësimit, përkatësisht kompensim nga agjencia private e punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim ne vend për detyrimet e paplotësuara të marrëveshjes për ndërmjetësim.

## Neni 38

(1) Agjencia private e punësimit me licencë për ndërmjetësim për punësim jashtë vendit është e detyruar, më së voni deri në datën 5 të muajit rrjedhës për muajin paraprak, të paraqesë të dhënat për personat e dërguar për punësim jashtë vendit, deri te Agjencia e Punësimit.

(2) Agjencia private për punësim me licencë për ndërmjetësim për punësim jashtë vendit është e detyruar të ruajë ekzemplar të marrëveshjeve të nënshkruara lidhur me ndërmjetësimin në pajtim me dispozitat për punë arkivore në hapësirat e punës ku është regjistruar selia e agjencisë.

## Neni 39

(1) Agjencia private për punësim me licencë për ndërmjetësim për punësim nuk mund:

- t'i detyrojë personat e dërguar për punësim të mundshme tek punëdhënësi potencial ta pranojnë ofertën ofruar,

- ta detyrojë punëdhënësin potencial që ta pranojë si punëtor personin e dërguar për punësim të mundshëm,

- të shfrytëzojë punë fëmijërore gjatë ndërmjetësimi për punësim të mundshëm dhe

- ta ofendojë dinjitetin dhe moralin e personave të dërguar për punësim të mundshëm.

(2) Agjencia private e punësimit me licencë për ndërmjetësim të punësimit është e detyruar, para lidhjes së marrëveshjes së ndërmjetësimi, në mënyrë të rregullt dhe në kohë me shkrim t'i njoftojë personat për punësim të mundshme dhe për kushtet për punën e ofruar.

## Neni 40

Për të gjitha të drejtat e punës që nuk rregullohen me këtë ligj, zbatohen dispozitat e rregulloreve të përgjithshme mbi marrëdhëniet e punës.

## V. EDUKIMI DHE DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

## Edukimi

## Neni 41

(1) Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i punës konstaton se është kryer parregullsi nga nenet 9, paragrafi (7), 14 paragrafi (5), neni 16 paragrafi (2), neni 18 paragrafi (1) alineja 1, neni 21 paragrafët (1) dhe (2), neni 23, neni 34 paragrafi (1), neni 36 paragrafi (1), neni 37 paragrafi (1) dhe neni 39 paragrafi (2) të këtij ligji, detyrohet të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer, me sugjerim për heqjen e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditëve dhe me dorëzimin e njëkohshëm të ftesës për zbatimin e edukimit të personit ose punëdhënësit ku është konstatuar parregullsia e përcaktuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për arsim, si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit i përcakton ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës.

(3) Edukimi organizohet dhe kryhet nga Inspektorati Shtetëror i Punës, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të zbatohet për më shumë parregullsi të njëjta ose të ngjashme të përcaktuara, për një ose më shumë punëdhënës.

(5) Nëse në termin e caktuar personi ose punëdhënësi mbi të cilin zhvillohet edukimi nuk shfaqet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është kryer.

(6) Nëse personi ose punëdhënësi mbi të cilin zbatohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe do ta mbarojë, atë do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori i punës gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë larguar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilën ndërpritet procedura e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori i punës gjatë zbatimit të mbikëqyrjes së kontrollit përcakton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, paraqet kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse para Komisionit Kundërvajtës.

(9) Inspektorati Shtetëror i Punës mban evidencë për edukimin e kryer, në mënyrën e përcaktuar nga ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës.

### Dispozita kundërvajtëse

#### Neni 42

(1) Gjobë me shumë prej 3.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik në agjencinë private të punësimit, me licencë për punësim të përkohshëm nëse:

- ka lidhur më shumë marrëveshje për punësime të përkohshme nga numri i paraparë në pajtim me licencën për lidhjen e marrëveshjeve të cilën e posedon (neni 7 paragrafi (3)),

- e zvogëlon numrin e të punësuarve në pajtim me nenin 9 të këtij ligji ose numrin e zvogëluar të të punësuarve nuk e plotëson në afat më të gjatë se 15 ditë (neni 15 paragrafi (1) alineja 3),

- agjencia private e punësimit kryen veprimtari në kundërshtim me veprimtarinë për të cilën është lëshuar licenca (neni 15 paragrafi (1) alineja 4),

- agjencitë private për punësimin e të punësuarve nuk u paguan rrogë dhe kompensime të rrogës, tre muaj nga dita e fillimit të obligimit (neni 15 paragrafi 1 alineja 7),

- në marrëveshjen e punësimit me punëtorin e përkohshëm të agjencisë, vendos dispozitë me të cilën ndalohet ose pengohet lidhja e marrëveshjes për punësim ndërmjet punëtorit të përkohshëm dhe punëdhënësit shfrytëzues (neni 22),

- lidh marrëveshje për punësim me punëtorin e agjencisë së përkohshme për punë të njëjta të përkohshme me ndërprerje ose pa ndërprerje në periudhë më të gjatë nga sa parashihet me këtë ligj (neni 24 paragrafi (2) dhe (3)),

- paguan kompensim për shërbimet nga punëtorët e agjencive të përkohshme për punën e kryer (neni 25 paragrafi (2)),

- nuk lidh marrëveshje për sistematizimin e punëtorëve të përkohshëm të agjencisë, nuk e lidh në formë të shkruar dhe nuk ruan ekzemplar të saj në lokalet e tij të punës në të cilën është regjistruar selia e agjencisë private për punësim dhe punëdhënësit shfrytëzues (neni 26 paragrafët (1), (2), dhe (3)),

- marrëveshja për tërheqjen e punëtorit e lidhur me punëdhënësin shfrytëzues detyrimisht nuk i përmban të dhënat e parapara në pajtim me këtë ligj (neni 26 paragrafi (4)),

- lidh marrëveshje për tërheqje të punëtorit të përkohshëm të agjencisë në kundërshtim me këtë ligj (neni 26 paragrafi (5) alineja 1 dhe 2),

- nuk përgatit dhe nuk dorëzon llogari të veçantë për rroga dhe kompensime të rrogës për punëtorët e punësuar të agjencisë të punëdhënësit shfrytëzues për çdo punëdhënësit shfrytëzues veçmas dhe për të punësuarit në agjencinë private të punësimit me licencë për punësime të përkohshme, veçmas (neni 27 paragrafi (1)),

- nuk i paguan rrogë dhe kompensime të rrogës punëtorit të tërhequr të përkohshëm të agjencisë në ditë pune prej ditës së pagimit të mjeteve nga punëdhënësi shfrytëzues (neni 27 paragrafi (2)),

- nuk i paguan obligimet e rrogës dhe kompensimeve të rrogës ndaj punëtorit të tërhequr të agjencisë së përkohshme, përkatësisht nëse punëdhënësi nuk paguan një faturë ndaj agjencive private të punësimit (neni 28),

- nuk lidh marrëveshje për punësimin e punëtorit para tërheqjes së punëtorit të punëdhënësit shfrytëzues në pajtim me dispozitat nga sfera e marrëdhënieve të punës (neni 29 paragrafi (1)),

- lidh marrëveshje për punësim me punëtorin i cili tërhiqet te punëdhënësi shfrytëzues, pa i përmbajtur të gjitha elementet e përcaktuara me këtë ligj (neni 29 paragrafi (2)),

- lidh marrëveshje për punëtorin e përkohshëm të agjencisë me rrogë bazë më të vogël nga rroga themelore të punëtorit të punëdhënësit shfrytëzues që punon në punë të njëjta, nëse të tillë nuk ka, i cili punon në punë të njëjta (neni 30 paragrafi (1)),

- e prish marrëveshjen për punësim me punëtorin e përkohshëm të agjencisë në afat tjetër të dorëheqjes nga afati i dorëheqjes të përcaktuar me këtë ligj (neni 33 paragrafi (1) dhe

- ia prish marrëveshjen e punësimit punëtorit të përkohshëm të agjencisë para kalimit të afatit të përcaktuar në marrëveshjen për shkak të ndërprerjes së nevojës nga punëtor i agjencisë së përkohshme për punëdhënësin shfrytëzues, përpos në rast të tërmetit, zjarrit, përmbytjeve dhe fatkeqësive të tjera elementare (neni 33 paragrafi (2)).

(2) Gjobë me shumë prej 30% nga gjoja e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

#### Neni 43

(1) Gjobë me shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik në agjencinë private të punësimit, me licence për punësim të përkohshëm nëse:

- nuk e informon ministrinë kompetente për punët nga sfera e punës për hapjen e filialit në afat prej pesë ditëve nga dita e hapjes (neni 9 paragrafi (7)),

- gjatë ndërprerjes së licencës, në pajtim me këtë ligj, nuk i ç'lajmëron punëtorët e agjencisë së përkohshme (neni 16 paragrafi (2) dhe

- tërheq punëtorin e agjencisë së përkohshme te punëdhënësi shfrytëzues, pa lidhur marrëveshje për punësim (neni 18 paragrafi (1) alineja 2).

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoja e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

#### Neni 44

(1) Gjobë me shumë prej 3.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit shfrytëzues të punëtorëve të agjencive të përkohshme nëse:

- nuk siguron kushte të njëjta themelore për punë dhe punësimin e kalimit të punëtorëve të agjencisë së përkohshme për punëtorët e vet (neni 19),

- nuk i informon punëtorët e agjencisë së përkohshme për të gjitha shpalljet e publikuara për vendet e lira të punës me shfaqjen e shpalljes publike në vende të dukshme në të gjitha hapësirat e punës, me poste elektronike ose SMS porosi (neni 21 paragrafi (1)),

- nuk siguron qasje të barabartë për punëtorët e përkohshëm deri te trajnimet e parapara si për punëtorët e vet (neni 21 paragrafi (2)),

- lidh kontratë për kalimin e punëtorit të agjencisë së përkohshme në kundërshtim me këtë ligj (neni 24 paragrafi (1) alinetë 1-6),

- ekzemplar për çdo kontratë të lidhur për kalimin e punëtorëve të agjencisë së përkohshme nuk ruan në lokalet e punës në të cilat është e regjistruar selia e agjencisë private për punësimin e punëdhënësit shfrytëzues (neni 26 paragrafi (3)),

- punëdhënësi shfrytëzues punëtorin e tërhequr të agjencisë së përkohshme e ritërheq te punëdhënësi tjetër shfrytëzues (neni 26 paragrafi (5) alineja 2),

- nuk paguan një faturë agjencisë private për punësimin e personave në afat të përcaktuar në marrëveshjen për tërheqje (neni 28),

- nuk jep të dhëna të sakta për agjencinë private të punësimit me licencë për punësimet e përkohshme për shumën e rrogës bazë për vendin e punës ose për atë personalisht nuk ka një vend të tillë të punës në të cilin punon punëtori i agjencisë së përkohshme (neni 30 paragrafi (2)),

- punëdhënësi shfrytëzues e vendos punëtorin e agjencisë së përkohshme në situatë jo të volitshme në pajtim me këtë ligj, ligj tjetër, marrëveshje kolektive dhe akt të punëdhënësit shfrytëzues (neni 31 paragrafi (3) alineja 3) dhe



- e prish marrëveshjen me agjencinë private për punësim me personat për punësim të përkohshme, para kalimit të afatit të përcaktuar në marrëveshje për shkak të mospasjes së nevojës për punëtor të përkohshëm të agjencisë së punëdhënësit shfrytëzues, përpos në rast të fuqisë madhore (neni 33 paragrafi (2)).

(2) Gjobë me shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë me shumë prej 150 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik.

#### Neni 45

(1) Gjobë me shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik - agjencisë private të punësimit me licencë për ndërmjetësim të punësimit nëse:

- agjencia private gjatë punësimit me licencë për ndërmjetësim, dy muaj një pas një ose tre muaj në vitin kalendarik, nuk dorëzon në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë të dhëna për personat të udhëzuar për punësimin e mundshëm në pajtim me nenin 38 të këtij ligji (neni 15 paragrafi (1) alineja 8),

- fillon të kryejë shërbime për ndërmjetësim të punësimit pa nënshkruar marrëveshje për ndërmjetësim me punëdhënësin potencial në të cilin janë përcaktuar kushtet për punësim (neni 36 paragrafi (2)),

- kërkon ose paguan kompensim për shërbimin e ndërmjetësimit nga personi i udhëzuar për punësimin e mundshëm (neni 34 paragrafi (3)),

- ndërmjetësimin gjatë punësimit e kryen në kundërshtim me këtë ligj (neni 35 paragrafi (1) dhe (2)),

- lidh marrëveshje me punëdhënësin potencial për ndërmjetësim të punësimit në vendin në të cilin nuk janë të rregulluara kushtet dhe mënyra e punësimit me ndërmjetësim në vend (neni 36 paragrafi (2)),

- lidh marrëveshje me punëdhënësin potencial në vend, i cili nuk i përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj (neni 36 paragrafi (3)),

- lidh marrëveshje me punëdhënësin potencial për ndërmjetësim të punësimit në të cilin nuk janë të rregulluara kushtet dhe mënyra e punësimit me ndërmjetësim në vend të huaj (neni 37 paragrafi (2)),

- lidh marrëveshje me punëdhënësin potencial në vend të huaj, i cili nuk i përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj (neni 37 paragrafi (3)),

- nuk lidh kontratë për ndërmjetësim në vend të huaj me personin kërkuar të punës për përcaktimin e ndërsjellë të të drejtave dhe obligimeve ose marrëveshja nuk i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 37 paragrafi (4) dhe (5)),

- nuk siguron para-kontratë për punësim me punëdhënësin potencial nga vendet e huaja, në pajtim me këtë ligj ose para-marrëveshjen nuk e dorëzon në kontroll te kërkuesi i punës, me ofertë për nënshkrim me dorën e tij (neni 37 paragrafi (6)),

- nuk e paguan kompensimin në pajtim me ndërmjetësimin e personit i cili udhëzohet për punësim të mundshëm në vend të huaj (neni 37 paragrafi (8)),

- i detyron personat e udhëzuar për punësim të mundshëm të punëdhënësi potencial që ta pranojnë ofertën e punës (neni 39 paragrafi (1) alineja 1),

- e detyron punëdhënësin potencial që ta pranojë për punë personin e udhëzuar për punësimin e mundshëm (neni 39 paragrafi (1) alineja 2),

- përdorë punën e fëmijëve gjatë ndërmjetësimit për punësimin e mundshëm (neni 39 paragrafi (1) alineja 3),

- e shkel dinjitetin dhe moralin e personave të udhëzuar për punësim të mëtejme (neni 39 paragrafi (1) alineja 4) dhe

- në mënyrë të parregullt dhe me vonesë i informon personat për punësimin e mundshëm për kushtet për punën e ofruar (neni 39 paragrafi (2)).

(2) Gjobë me shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

#### Neni 46

(1) Gjobë me shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik - agjencisë private të punësimit me licencë për ndërmjetësim të punësimit nëse:

- nuk dorëzon të dhëna në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, deri më pesë të muajit rrjedhës për muajin paraprak, për personat e udhëzuar në vende të huaja (neni 38 paragrafi (1)) dhe

- nuk i ruan marrëveshjet për ndërmjetësim në pajtim me dispozitat për punë të arkivit në lokalet e punës në të cilat është regjistruar selia e agjencisë (neni 38 paragrafi (3)).

(2) Gjobë me shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

#### Neni 47

(1) Gjobë me shumë prej 2.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik si punëdhënësi potencial nëse:

- lidh marrëveshje me agjencinë private të punësimit, me licencë për ndërmjetësim në vendin, në të cilin nuk përmbahen kushtet për punësim me personin e udhëzuar për punësimin e mundshëm (neni 36 paragrafi (2)),

- nuk e informon agjencinë private të punësimit me licencë për ndërmjetësim për rezultatet e intervistës për punësim me personin e udhëzuar për bisedë për punësimin e mundshëm (neni 36 paragrafi (3)),

- nuk lidh marrëveshje me personin e zgjedhur për punësimin e mundshëm (neni 36 paragrafi (4)) dhe

- nuk ia paguan obligimet e kontraktuara, në pajtim me marrëveshjen për punësim që e ka lidhur me personin e udhëzuar për punësim të mundshme (neni 36 paragrafi (5)).

(2) Gjobë me shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë me shumë prej 150 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - personit fizik.

#### Neni 48

Gjobë me shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar në organin i cili e udhëheq procedurën dhe organin publik kompetent prej të cilit janë kërkuar dëshmitë dhe të dhënat nëse:

- nuk i grumbullon dëshmitë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 5 paragrafi (2)),

- nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara dhe të dhënat në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 5 paragrafi 3) dhe

- nuk vendos për kërkesën në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 13).

#### Neni 49

Për kundërvajtjet e konstatuara në nenet 42, 43, 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji procedura kundërvajtëse mban edhe sanksion kundërvajtës dhe e shqipton organi - Komisioni Kundërvajtës, në kuadër të ministrisë kompetente për punët nga sfera e punës.

**Barazimi**

Neni 50

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji konstatohet shkelje e cila është e përcaktuar si kundërvajtje me këtë ligj, nga personi i autorizuar zyrtar, kryerësit të kundërvajtjes detyrimisht do t'i ofrohet procedurë për barazim, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

**Përcaktimi i dënimit**

Neni 51

Përcaktimi i shumës së gjobës për personin juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Neni 52

Inspektorati Shtetëror i Tregut, për kontrollet e kryera përgatit raporte tremujore, të cilat publikohen në ueb faqen e ministrisë kompetente për punët nga sfera e punës dhe në ueb faqen e Inspektoratit Shtetëror të Punës.

**VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 53

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për agjencitë e punësimeve të përkohshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/2006, 102/2008, 145/10, 136/11, 13/13, 38/14, 98/15, 147/15, 27/16, 119/16 dhe 21/18).

Neni 54

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 55

(1) Agjencitë ekzistuese për punësime të përkohshme dhe agjencitë për ndërmjetësim të punësimit, janë të obliguara të dorëzojnë kërkesë në pajtim me këtë ligj për dhënien e licencave nga neni 7 paragrafi (1) të këtij ligji, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Agjencive ekzistuese për punësime të përkohshme dhe agjencive për ndërmjetësim të punësimit të cilat nuk do të dorëzojnë kërkesë në afatin e paragrafit (1) të këtij neni, do t'u ndërpritet vlefshmëria e licencave të lëshuara para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 56

Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë në pajtim me Ligjin për agjenci të punësimeve të përkohshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/2006, 102/2008, 145/10, 136/11, 13/13, 38/14, 98/15, 147/15 dhe 27/16) dhe Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003, 37/2004, 4/2005, 50/2006, 29/2007, 102/2008, 161/2008, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12, 114/12, 39/14, 44/14, 113/14, 56/15, 129/15, 147/15, 154/15, 27/16, 119/16 dhe 21/18).

Neni 57

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit të "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**2188.**

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

**У К А З****ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЗАШТИТА НА ПРИРОДАТА**

Се прогласува Законот за изменување на Законот за заштита на природата, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 14 јуни 2018 година.

Бр. 08-3816/1  
14 јуни 2018 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
д-р **Горге Иванов**, с.р.

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
м-р **Талат Цафери**, с.р.

**ЗАКОН  
ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЗАШТИТА  
НА ПРИРОДАТА****Член 1**

Во Законот за заштита на природата („Службен весник на Република Македонија“ број 67/2004, 14/2006, 84/2007, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13, 41/14, 146/15, 39/16 и 63/16), во членот 141 став (5) точка 5) во алинејата 5 сврзникот „и“ се заменува со сврзникот „или“.

Во алинејата 6 знакот точка запирка се заменува со точка.

Точката 6) се брише.

Точката 7) станува точка 6).

**Член 2**

Во членот 170 став (1) алинеја 5 бројот „300“ се заменува со бројот „240“.

Алинејата 8 се менува и гласи:

„- поседува потврда за познавање на компјутерски програми за канцелариско работење и“.

Алинејата 9 се брише.

**Член 3**

Одредбите од членот 141 став (5) точка 5) од Законот за заштита на природата („Службен весник на Република Македонија“ број 67/2004, 14/2006, 84/2007, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13, 41/14, 146/15, 39/16 и 63/16) нема да се применуваат од денот на влегувањето во сила на овој закон до 1 септември 2018 година.

**Член 4**

Директорот кој е именуван во периодот од денот на влегувањето во сила на овој закон до 1 септември 2018 година, е должен да го исполни условот за познавање на англиски јазик најдоцна во рок од една година од денот на неговото именување.

На директорот кој нема да го исполни условот за познавање на англиски јазик во рокот утврден во ставот 1 на овој член му престанува мандатот.

**Член 5**

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

**L I G J  
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE  
TË NATYRËS****Neni 1**

Në Ligjin për mbrojtje të natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 67/2004, 14/2006, 84/2007, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13,